ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT - OSHP

Në përputhje me nenin 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, OE "Companya Eskavatori" sh.p.k, brenda afatit ligjor parashtron këtë:

ANKESË

Lidhur me aktivitetin e prokurimit: 217-22-1373-5-2-1

Sa i përket tenderit me titull: Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçare
Pjesa 1 Ndërtimi i pikës së karburantit (Kazerma Istog)
Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë)
Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin)
Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim-(Kazerma Pomozotin)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

EVERLIGHT SHPK
RR.FAZLI BALAJ PN PRISHTINE
NU 810871807
Prishtinë, 10 000

Arbnor Zekolli

28.03.2022

_____

_____

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____

_____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë me titull: **"Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçare**
Pjesa 1 Ndërtimi i pikës së karburantit (Kazerma Istog)
Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë)
Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin)
Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim-(Kazerma Pomozotin) ".

Aktiviteti i prokurimit nr. **217-22-1373-5-2-1**

Kriter i dhënies së tenderit ka qenë : **ÇMIMI EKONOMIKISHT MË I FAVORSHËM**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☑

Ankesa është bërë para se të bëhet hapja e tenderëve.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☑

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne Pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës tuaj për rishqyrtim.

ANKESA 1

Te Kërkesa 14.
Pjesa 2
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale : Ju lutem sqaroni si keni menduar kete a] Kërkesa 14, nuk është duke u kuptuar a është fjala për 1 apo për 2 inxhinierë ?!
Nuk definohet saktë nëse keni kërkuar një apo dy Inxhinierë.

ANKESA 2
Te Kërkesa 16
Pjesa 2

Raporti për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve ndërtimore
• Kamion kiper me kapacitet min 10 ton (1 2+copë)
• Bager, eskavator ose ngarkues (1+1 copë)
•Betonare ose marrveshje me nje prodhus të betoni të licencuar per furnzim me beton
•Automjete per bartjen e betoni –mikser – (1 copë)
•Pahi minimumi 200m2 vetem pjesa 2
•Automjete per bartjen e betoni –mikser – (2 copë)
•Pompe per shpërndarjen e betoni (1 copë)
Pra, ju lutem na tregoni si kriter nese :
• Kamion kiper me kapacitet min 10 ton (1 2+copë) – kërkohen 12 copë apo cka nënkupton 1 2 + copë
- Këto Kërkesa janë të panevojshme, për derisa kemi të bëjmë me punë të elektrikes, ndriçimit të jashtëm, dhe nëse analizohet paramasa afërsisht 90% janë punë elektrike, ndërsa 10% punë të ndërtimtarisë dhe arkitekturës. Dhe AK nuk ka kërkuar makineri të domosdoshme si kran për vendosjen e shtyllave me atë lartësi h=11 dhe korp për demolimin dhe instalimin e trupave ndriçues të cilat shërbejnë për punë kryerje. Ne paramases kemi shtylla me h=11m përveç tjerash, andaj me thoni ju si AK si e keni menduar me këto makineri qe I keni paraparë ne FDP të ngrihet ose te montohet një shtylle e tillë, ne këtë rast nuk është paraparë as një pozicion trajtimi i mbetjeve te trupave ndriçues.
Andaj ne Kërkojmë që këto kërkesa të largohen nga Pjesa 2 sepse Ne na pamundëson pjesëmarrjen në këtë projekt, duke pare që ato kërkesa qe ju keni përshkruar janë plotësisht te panevojshme për Pjesën 2.
Mos largimi i këtyre Ne konsiderojmë Shkelje te rende dhe diskriminuese.

ANKESA 3

Paramasa

Pozicioni 2.2.18 Blerja, bartja dhe zevendesimi i reflektoreve ekzistues me trupa ndriçues, IP66 te tipit LED me keto karakteristika:

Luminous flux (Luminaire): 100 lm/W

Luminous Flux: 24000 lm

Luminaire classification according to DIN: A30

Colour Temperature 6500K

Luminaire Wattage: 150.0 W

Input Voltage: 220-240

Si ka mundesi 24000lm te na jap nje Trup ndriques 150W kur ajo kerkohet te jete100lm/W

Me qfar eshte llogaritur kjo apo si mund te gjindet ne treg nje Trup ndriques si ky?

Për korrektësi ne mënyrë inxhinierike kalkulimi duhet te llogaritet W x LM/W=LM!

Për me tepër legjislacioni vendor e rregullon efiçencën e produkteve si ne ligjin nr. 06/l -079 për efiçencë të energjisë përkatësisht nenin 9 te këtij ligji dhe UA qe buron nga ky ligj "Udhëzim Administrativ (MEA) nr. 03/2020 Lidhur me Kërkesat për Efiçiencën e Energjisë për Blerjen e Produkteve Shërbimeve dhe Ndërtesave nga Institucionet e Nivelit Qendror". Niveli Qendror është i obliguar qe produktet te cilat konsumojnë energji, ti blejnë me efiçencë te lart për te cilën edhe ne shtetitet e BE-se qe i referoheni edhe ju si AK, nuk përdoren me 100lm/w! por me shumë se 160lm/w qe nënkupton se kursimi i energjisë elektrike ne këtë rast do te duhet te jete rreth 40% ne raport me planifikimin e këtij projekti.

Gabime teknike ne efiçencë te produktit ka edhe ne pozicionet: 2.2.11 dhe 2.2.19!

Gjithë ashtu edhe tensioni punues me kete voltazh si 220-240V, as nje kompani nuk mund te garantoj për produktet e tyre për te cilin keni kërkuar 7 vite garancion, duke ditur qe tensioni i energjisë elektrike ne Kosovë nuk është stabile, pra për te garantuar një Produkt duhet te kete interval me te gjate te tensionit te energjisë elektrike p.sh. 90-305V apo them me mire siq ju keni shkruar ne Pershkrim qe Driveri te jete MeanWell apo i ngjashem, Kompania Meanwell nuk prodhon Driver me kete tension 220-240V por 90-305V.

PROPOZIM:

Duke marrë parasysh këto shkelje të dispozitave të LPP-së si, i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik që pas analizimit dhe vlerësimit të kësaj ankese, të marrë **VENDIM** me të cilin të **ANULOJ** Procesin e Hapjes së Tenderëve Autoritetit Kontraktues Ministria e Mbrojtjes të datës 28.03.2022, dhe vendim të kërkoj nga AK të ndryshoj kushtet/kriteret dhe të caktoj afatin sipas ligjit për **RITENDERIM.**

Prishtinë, 28.03.2022

"EVERLIGHT" sh.p.k.,

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
EVER LIGHT
consulting
10000 - Prishtinë - Kosovë

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojmë se shkeljet e cekura më lartë kanë shkaktuar humbje të konsiderueshme materiale, kjo nga shkaku se kemi humbje materiale lidhur me kostot që kanë të bëjnë me përgatitjen e ofertave. Kemi po ashtu humbje të konsiderueshme edhe sa i përket taksave të cilat jemi obliguar që t'i paguajmë për të siguruar garancionin bankar për sigurimin e tenderit në të gjitha rastet e tenderimit të kësaj kontrate si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me përgatitjen e ankesave.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura: